

---

## **SOCIOLOGJIA**

---

(2 orë në javë, 64 orë në vit)

---

### **HYRJE**

Lënda e sociologjisë XIII mundëson që nxënësit të fitojnë dituri lidhur me rastet, dukuritë, fenomenet dhe proceset në shoqërinë bashkëkohore. Përmbajtjet mësimore kanë për qëllim t'i aftësojnë nxënësit për të qenë të përgatitur për jetë, njëkohësisht që ata të mos ndjehen inferior në shoqëri, por të interesuar për të shprehur aftësitë dhe potencialet e tyre individuale dhe të gjeneratës. Sociologjia jep dije dhe kulturë shkencore për nxënësit, në mënyrë që ata të ndjehen pjesë aktive dhe krijuese e dinamike të zhvillimit dhe të përparimit të shoqërisë.

Nxënësit do të fitojnë dije, duke punuar në përmbajtje tematike dhe, po kështu, do të aftësohen në aspektin intelektual dhe etik, në mënyrë që të marrin edhe vetë përgjegjësi shoqërore në realizimin e projekteve me interes jo vetëm për veten e tyre, por edhe për shoqërinë.

Sociologjia krijon njohuri dhe aftësi vlerësimi më të drejtë të të rinjëve për dimensionin social të individit dhe të grupit, i njeh me teoritë dhe rezultatet më të reja të arritura në sociologjinë bashkëkohore si dhe ua shton përgjegjësinë për të punuar, duke respektuar obligimet, por edhe duke gëzuar të drejtat individuale dhe kolektive. Mendimi sociologjik është zhvilluar përmes hulumtimeve në fusha të ndryshme të shoqërisë dhe rruga më e mirë do të jetë krijimi i mundësive që edhe vetë nxënësit të njohin dhe të hulumtojnë dukuritë sociale.

Programi i sociologjisë për drejtimet e përgjithshme të shkollave të mesme është një paraqitje e çështjeve dhe e problemeve themelore sociologjike, pikërisht duke pasur parasysh interesin dhe arsimimin sociologjik të nxënësve të kësaj moshe.

Programi themelor synon të krijojë nxënës që mbërrijnë të nxjerrin vlerësim kritik personal, pastaj njohje me teknologjinë, nocionet më esenciale të sociologjisë bashkëkohore si dhe që nxënësit të paraqiten në

rolin e gjetjes, të përpunimit dhe të integritit të fakteve sociologjike në qasjet dhe punimet e tyre autoriale. Do të preferohet edhe ofrimi i përmbajtjeve të shkurtra të teksteve më tipike dhe domethënëse të sociologëve më të njohur për çështjet që janë të lidhura me përmbajtjet programore.

Lënda e sociologjisë XIII në shkollën e mesme do të mësohet dy orë në javë, përkatësisht 74 orë në vit.

Plani dhe programi i sociologjisë për klasat XIII të gjimnazit do të përmbajë njohuri të mjaftueshme për nxënësit.

## **QËLLIMET**

**Përmes të mësuarit të lëndës së sociologjisë në klasën XIII të drejtimeve të gjimnazit të përgjithshëm, synojmë të arrihen këto qëllime:**

1. Të kompletohet fondi i informatave, i përmbajtjeve dhe i të dhënave që sociologjia ofron si shkencë e përgjithshme shoqërore. Me kurset paraprake, nxënësit janë njoftuar me kategoritë themelore të sociologjisë, kurse me këtë program të sociologjisë ofrohet një qasje më kritike, por mjaft e avancuar për të rrumbullakësuar njohuritë për këtë shkencë.
2. Që nxënësve t'u ofrohen njohuri nga kategoritë sociologjike, të cilat, sidomos në pjesën e parë të programit, janë produkt i krijimtarisë së sociologëve, që mësimin mbi sociologjinë e kanë pavarësuar nga konteksti paraprak filozofik dhe e kanë ngritur në nivelin e teorive të qendrueshme dhe të mbështetura shoqërore.
3. Me futjen e formave të reja të qasjeve ndaj institucioneve shoqërore (vizitat, kontaktet e gjalla dhe shkruarjen e eseve, nxënësi në këtë kurs do të ballafaqohet me realitetin e shoqërisë ku jeton në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetës dhe interpretues. Vizitat në institucione kanë për qëllim çmitizimin dhe demistifikimin e ambienteve, që për nxënësin e kësaj moshe është parakusht i integritit në shoqëri.
4. Që të zhvillojë aftësitë e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike dhe kreative për individin, grupin dhe shoqërinë si dhe për vetveten, duke u bazuar në njohjen dhe kuptimin e nocioneve themelore sociologjike.

5. Që të jetë në gjendje t'i identifikojë dukuritë negative aktuale në shoqëri dhe t'i luftojë, ndërsa ato pozitive t'i avancojë;
6. Që nxënësi të ndjejë më afër realitetin e tëhuajshuar shoqëror dhe politik, të nxitet të mendojë për shoqërinë si i rritur dhe i aftë të japë kontributin e vet në rrjedhat e saj.
7. T'i zhvillojë proceset kognitive në shtjellimin dhe në kuptimin e proceseve shoqërore:
8. Kursi i propozuar për këtë moshë të nxënësve ofron mundësi të thellimit dhe të zbatimit të njohurive të fituara në rrjedhat shoqërore. Teoria shoqërore, politika, institucionet, rrjedhat demografike, familja, pozita e femrës etj. Pas këtij kursi të sociologjisë, për nxënësit të mos mbeten brengë e të "rriturve" dhe të zyrtarëve, por edhe e tyre.
9. Të zhvillojë shkathtësi të përhershme të nxënësit për të kuptuar dhe për të përdorur nocionet dhe rezultatet sociologjike si në të folur po kështu edhe në të shkruar.
10. Të nxisë raporte humane dhe krijuese në familje, grupe, shkollë, shoqëri.
11. Të përgatitet për studime të mirëfillta dhe serioze në lëmin e shkencave sociale përgjithësisht, mirëpo edhe të shkencave të tjera, pasi që sociologjia është e vetmja shkencë që në arsimin e lartë mësohet në të gjitha fakultetet.
12. Të mposhtë frustrimet dhe ngurrimet, që te shumica e fëmijëve të kësaj moshe manifestohen – si pasojë e formimit në ambientin familjar patriarkal si prirje për nënshtrim autoriteteve, por edhe nga mosnjoha e specifikave të funksionimit të individëve, grupeve dhe institucioneve në shoqëri.
13. Të inkurajohet e të mos ngurojë të kyçet në debate dhe paraqitje publike, të shpreh mendimin dhe qëndrimin e vetë lirshëm.

### **OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM DHE SPECIFIKË**

Mbështetur në qëllimet që shtrihen në programin për lëndën e sociologjisë XIII, përmabjtjet mësimore synojnë të arrijnë këta objektiva:

- 1. Pas njoftimit me kategoritë themelore të sociologjisë, nxënësit në këtë kurs do të avancojnë njohjen dhe pasurojnë diturinë me interpretime shkencore nga pozicione të ndryshme që dalin nga teoricienët që kanë pasur dhe kanë preokupim shoqërorin dhe ligjësitë e funksionimit të saj.**
- 2. Të krijojë njohuri shkencore për transformimin e shoqërisë njerëzore në të kaluarën dhe të hapë rrugë për zhvillimin e sotëm shoqëror.**
  - 2A. Të krijojë njohuri të mjaftueshme për zhvillimin e mendimit sociologjik dhe të sociologjisë si shkencë shoqërore si dhe për metodologjinë e hulumtimit të lëndës së saj.
  - 2B. Të vazhdojë studimin e kategorive të përgjithshme shoqërore në kontinuitetin historik të zhvillimit të tyre.
- 3. Të mësojë për mekanizmat e funksionimit shoqëror, krijimin, transformimin dhe avancimin e tyre.**
- 4. Ta mundësojë integrimin e individit në rrjedhat e mirëfillta të zhvillimeve shoqërore.**
  - 4A. Të fitojë njohuri për raportet individ – grup – shoqëri dhe për grupet e tjera shoqërore.
  - 4B. Të hetojë rolin e individit dhe të grupit në stimulimin e rrjedhave shoqërore, krijimin e jetës institucionale, avancimin dhe tejkalimin e formave tradicionale dhe respektimin e ligjeve pozitive në shoqëri.
  - Të lirohen nga paragjykimet eventuale që manifestohen si mostolerancë nga gjithë ajo që është ndryshe nga kultura, raca, religjioni, përkatësia gjinore, bindja politike etj.
  - Të mos mbeten në pozicionet e mostrave të trashëguara nga mjediset ksenofobe, por të ndihmohet krijimi i mendjes së hapur të nxënësit.
- 5. Të shpjegojë fenomenet dhe proceset shoqërore**
  - 5A. Të gjykojë drejt për fenomenet dhe proceset shoqërore, pa marrë parasysh ato nëse janë pozitive apo negative.

- 5B. Që fenomenet shoqërore të mos trajtohen dhe të analizohen vetëm nga një dimension, por të trajtohen si fenomene shumë-dimensionale.
- 6. Të kuptuarit e sociologjisë do ta mundësojë shmangien nga interpretimet e ngushta jokrtike të rrjedhave shoqërore.**
- 6A Ta kuptojë esencën, rolin dhe rëndësinë e institucioneve shoqërore dhe të jetës së institucionalizuar.
- 7. Të japë mendime për tejkalimin e problemeve dhe të vështirësive shoqërore.**
- 7A Të kuptojë drejt shtresëzimin shoqëror dhe konfliktet që ndodhin në shoqëri dhe të bëjë të mundshmen e tij për parandalimin e konflikteve.
- 8. T'i kuptojë proceset normale të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore.**
- 8A. Të kuptojë që ndryeshshmëria në kulturë dhe në format e tjera të vetëdijes të jenë pasuri shpirtërore e jo burim i konflikteve.
- 9. T'i kuptojë ndryshimet shoqërore si nevojë e avancimit të cilësisë së jetës, të botëkuptimeve dhe të sjelljeve, e jo si shkapërderdhje të dhembshme të strukturave patriarkale, tradicionale dhe të ngurta.**
- 9A Të vetëdijësohet për rolin e vet aktiv në përkrahjen e proceseve shoqërore të cilat çojnë kah ngritja e nivelit të vetëdijes dhe shkapërputja nga mostrat e vjetruara të funksionimit të individit në shoqëri.



<p><b>qeverisjes</b></p> <p><b>Demokracia</b></p>		<p>tipologjia klasike, monarkia dhe republika, tipologjitë e tjera, qeveria e përzier</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demokracia dhe diktatura</li> <li>• Demokracia në teorinë e formave të qeverisjes, në kohën bashkëkohore</li> <li>• Demokracia e drejtpërdrejtë dhe e përfaqësimit, formale dhe esenciale</li> <li>• Diktatura e kohës antike dhe e kohës moderne</li> </ul>	<p>Nxënësi duhet të njoftohet me format e qeverisjes – duke marrë njohuritë elementare për format historike të organizimit të qeverisjes. Paraqitja e kësaj dukurie shoqërore kërkon një qasje kronologjike, pasi që ka të bëjë me një laryshi modusesh të realizuara në kontekstin kohor dhe shoqëror. Secila shoqëri ka specifikat e veta të realizimit dhe të ushtrimit të qeverisjes, që, po ashtu, është dëshmi e një dukurie mjaft specifike.</p>	
<p><b>Teoria pozitiviste e Ogyst Kontit</b></p> <p><b>Formalizmi evropian</b></p>	<p><b>Zhvillimi i mendimit sociologjik</b></p> <p><b>11 orë</b> <b>18.66%</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teoritë mekaniciste në sociologji, teoritë biologjiste, teoritë psikologjiste, teoritë individualiste psikologjiste, teoritë kolektive psikologjiste dhe teoritë sociale psikologjiste</li> <li>• Formalizmi në sociologji, <ul style="list-style-type: none"> <li>- nocioni dhe kufijtë e formalizmit,</li> <li>- përfaqësuesit kryesorë dhe faktorët që ndikuan në</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nxënësi duhet të dijë se cilat janë teoritë kryesore sociologjike</li> <li>- të jetë në gjendje të kuptojë se ku qëndorjnë dallimet mes tyre</li> <li>- të njihet me sociologët më të njohur</li> <li>- të jetë në gjendje vetë t'i shpjegojë teoritë e shoqërisë.</li> <li>- të dijë se cili ishte kontributi i secilit sociolog në shpjegimin e shoqërisë dhe të fenomeneve të saj</li> </ul>	<p>Me historinë, me filozofinë, me shkencat politike, psikologjinë, biologjinë</p>

<p><b>Hyrje në Teorinë e shoqërisë së Shkollës së Frankfurtit</b></p>		<p>paraqitjen e formalizmit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Formalizmi evropian</li> <li>• Ferdinand Tennis, Gustav RI, Georg Zimel, Leopold Von Vize dhe Zhorzh Gurviçi</li> <li>• Shkolla e Frankfurtit, Max Horkheimer, Theodor Adorno, Herbert Markucuze, Erich From, Franc Neuman dhe Jirgen Habermas</li> </ul>		
<p><b>Religjioni</b></p> <p><b>Normat shoqërore</b></p> <p><b>Ideologjia</b></p>	<p><b>Shoqëria njerëzore dhe format e besimit</b></p> <p><b>Ideologjia dhe identiteti</b></p> <p><b>10 orë</b></p> <p><b>13.33%</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Religjioni</li> <li>• Konceptet themelore, analiza teorike e religjionit, - religjioni dhe ndryshimet sociale, shikimi përpara: religjioni në shekullin XXI</li> <li>• Llojet e normave shoqërore, tradita dhe zakonet, morali</li> <li>• Funkcionet e ideologjisë, orientimet simbolike, legjitimiteti, solidariteti, identiteti,</li> </ul>	<p>- Nxënësi duhet të kuptojnë se shoqëria është një totalitet i gjerë i marrëdhënieve shoqërore dhe se shoqëria ka kaluar nëpër faza të ndryshme të zhvillimit të saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nxënësit duhet të njoftohen me funksionimin e shoqërive të organizuara, ku mbretërojnë normat dhe ligjet pozitive.</li> <li>• Po ashtu, nxënësit duhet njoftuar edhe me zanafillën e normave, të</li> </ul>	<p>Psikologjinë, etikën, të drejtën, edukatën qytetare, mjekësinë, demografinë, gjeografinë, arkitekturën, ekonominë, shkencat politike</p>

<p><b>Demografia</b></p> <p><b>Urbanizmi dhe</b></p>	<p><b>Konceptet themelore</b></p> <p><b>10 orë 14.66%</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ideologjia në shoqërinë moderne, liberalizmi, socializmi dhe nacionalizmi</li> <li>• Demografia, studimi i popullsisë, <ul style="list-style-type: none"> <li>- historia e shtimit të popullsisë,</li> <li>- nataliteti,</li> <li>- mortaliteti, shtimi natyror i popullsisë, transicioni demografik,</li> </ul> </li> <li>• Urbanizimi, rritja e qyteteve, urbanizimi si</li> </ul>	<p>cilat zakonisht në shoqëri të ndryshme kanë karakter dhe përmbajtje të ndryshme, varësisht nga niveli i zhvillimit të shoqërive të caktuara.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konteksti i normave përbën një përzierje të normave tradicionale, që burojnë nga zhvillimi historik, specifikat e zhvillimit dhe të rrethanave të shoqërive të caktuara dhe të normave ligjore të ligjësisë pozitive – që janë produkt i organizimit shoqëror.</li> <li>• Nxënësit duhet të njoftohen me specifikat e qasjeve demografike të studimit shoqëror.</li> <li>• Derisa shkencat e ndryshme shoqërore kanë si objekt studimi lëvizjet shoqërore, ndryshimet, zhvillimin dhe pasojat e atyre lëvizjeve, demografia si shkencë ka një qasje specifike shoqërore.</li> <li>• Proceset e ndryshimeve demografike që ndodhin si pasojë e lëvizjeve shoqërore, që</li> </ul>	
--	---	---	---	--

<p><b>perspektivat e zhvillimit të tij në shek. XXI</b></p> <p><b>Familja</b></p>		<p>formë e jetës, urbanizimi në shoqëritë e varfëra, shikimi përpara: urbanizmi në shek. XXI</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Familja, koncepti themelor i familjes, familja dhe ndryshimet shoqërore, shkenca e jetës</li> </ul>	<p>historikisht ishin të shpeshta dhe të zakonshme, demografia i studion në kontekstin e ndryshimeve ekonomike; pastaj potenciali shoqëror që të adaptohet në rrethana të caktuara të një mjedisi gjeografik, për krijimin e jetës shoqërore në të.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Demografia, po ashtu, këto lëvizje shoqërore i studion duke marrë për bazë regjistrimet e popullsisë si matës i bazuar i këtyre ndryshimeve. <ul style="list-style-type: none"> <li>- nataliteti,</li> <li>- mortaliteti,</li> <li>- shtimi natyror dhe koncepte të tjera, janë gjithnjë të vështruara në kontekstin e mjedisit jetësor, nevojave të përshtatjes së atij mjedisi individit dhe grupit, krijimin e vendbanimeve, të infrastrukturës dhe të potencialit strehues për nevojat e njeriut.</li> </ul> </li> </ul>	
<p><b>Familja dhe mosha</b></p>	<p><b>Konceptet themelore shoqërore</b> <b>7 orë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të rinjtë dhe gjenerata e re,</li> <li>• specifikat e rinisë,</li> <li>- problemet e rinisë në</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi të mësojë për funksionet themelore të familjes</li> <li>- për kujdesin shoqëror ndaj të</li> </ul>	

<p><b>Mosha dhe pleqëria</b></p> <p><b>Mbrojtja dhe barazia sociale</b></p>	<p><b>10.66%</b></p>	<p>shoqërinë moderne</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mosha dhe pleqëria</li> <li>• Barazia sociale, sigurimi pensional, sigurimi nga fatkeqësitë, sigurimi mjekësor, sigurimi i të papunëve.</li> <li>• Mbrojtja dhe ndihma sociale, burimet e solidaritetit, filantropia, kujdesi ndaj të sëmurëve dhe ndaj fëmijëve</li> </ul>	<p>sëmurëve, pleqve dhe të pafuqishmve</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me parimet themlore të barazisë sociale</li> <li>- të njoh format e sigurimeve dhe të mbrojtjes sociale në shoqëri dhe veçmas në vendin tonë-të nxitet te nxënësit ndjenja e humanizmit, e solidaritetit dhe e filantropisë</li> </ul>	
<p><b>Lëvizjet sociale, shoqëria civile</b></p>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lëvizja sociale, lëvizjet reformuese, lëvizjet e rezistencës, qytetare, lëvizjet utopike, mobilizimi i resurseve</li> <li>• Shoqëria civile, shprehja e lirë e interesit të qytetarit, qytetari</li> </ul>		
<p><b>Gjinia seksualiteti, gjinia, roli gjinor</b></p>	<p><b>5 orë</b> <b>8.00%</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjinia dhe seksualiteti</li> <li>• Gjinia dhe roli gjinor</li> <li>• Feminizmi</li> <li>• Gay-izmi dhe lezbianizmi</li> </ul>		<p>Demografinë, gjeografinë, arkitekturën, ekonominë politike, psikologjinë sociale,</p>

				informatikën, ekonominë, kulturën
<b>Kultura dhe funksioni shoqëror i kulturës</b>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultura dhe shoqëria</li> <li>• Llojet e kulturës</li> <li>• Funksioni shoqëror i kulturës</li> <li>• Kultura dhe religjioni</li> </ul>	<p>Nxënësit duhet të dijë se ç'është religjioni dhe cilat ishin format e hershme të besimeve;</p> <p>- të dijë se cilat janë fetë monoteiste dhe cilat janë karakteristikat e përbashkëta mes tyre;</p> <p>- të kuptojë se religjioni ka karakter shoqëror;</p> <p>- të kuptojë se ç'është shkenca dhe ç'është ideologjia dhe cilat janë dallimet mes tyre;</p> <p>- të dijë se ç'është e drejta dhe se ajo paraqet nivelin e zhvillimit shoqëror dhe kulturor të shoqërive konkrete;</p> <p>- të jetë në gjendje të identifikojë komponentet e moralit dhe ndikimin e tyre në shoqëri.</p>	Demografinë, gjeografinë, arkitekturën, ekonominë politike
<b>Kultura dhe shoqëria</b>				

<b>Mediat dhe shoqëria</b>	<b>4 orë 6.66%</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Masmediat në shoqërinë moderne, <ul style="list-style-type: none"> <li>- llojet dhe funksioni i masmediave</li> <li>- ndikimi i masmediave në krijimin e opinioneve, publiku medial, publiciteti</li> </ul> </li> <li>• Subkultura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë se ç'është masmedia, ku qëndron dallimi ndërmjet shtypit dhe mediave elektronike</li> <li>- pse sot mediat konsiderohen forcë e katërt në shoqëri, pas legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit</li> <li>- të kuptojë si ndikojnë mediat në krijimin e opinioneve lokale, rajonale, nacionale dhe globale</li> <li>- të identifikojë problemet që sjellin përmbajtjet problematike mediale për individin dhe shoqërinë</li> <li>- të identifikojë subkulturën në mjedisin shoqëror ku jeton</li> </ul>	Me psikologjinë sociale, informatikën, ekonominë, kulturën
<b>Sociologjia e sportit</b>  <b>Sociologjia e artit, funksioni shoqërori</b>	<b>Shoqëria dhe sporti</b>  <b>4 orë 5.33%</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sporti dhe shoqëria, <ul style="list-style-type: none"> <li>- sporti amator,</li> <li>- sporti profesional,</li> <li>- marketingu, sponsorizimi, publiku , simaptizuesit ekstremë, etika në sport, nacionalizmi dhe sporti</li> </ul> </li> <li>• Shoqëria dhe arti, <ul style="list-style-type: none"> <li>- ndikimi i artit në shoqëri,</li> <li>- teatri dhe shoqëria,</li> <li>- filmi, libri, muzika</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë se cili është dimensionin social i sportit</li> <li>- të dallojë tipat e funksionimit të sporteve;</li> <li>- të dijë se cilat janë problemet që paraqiten në raportin sporti - publiku</li> <li>- të zhvillojë njohuritë për etikën sportive si formë e tolerancës dhe e mirëkuptimit social</li> <li>- të dijë se cilat janë dallimet ndërmjet gjeneratave, të njohë</li> </ul>	Me psikologjinë, mjekësinë, ekonominë, informatikën



## UDHËZIME METODOLOGJIKE

Në procesin e mësimdhënies së lëndës së sociologjisë mund të zbatohen metoda të ndryshme. Cila metodë do të pëdoret gjatë orës mësimore është në kompetencë të mësimdhënësit. Zakonisht, mësimdhënësi duhet t'i aplikojë metodat varësisht nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, veçoritë e përmbajtjes së temës, nga mosha dhe aftësia e nxënësve për absorbim të njohurive të reja si dhe dëshira e arsimtarit që të nxënësit të krijojë shprehje pune me tekst dhe në mënyrë të pavarur.

Që plani dhe programi të realizohet në mënyrë sa më cilësore, arsimtari duhet të nxisë mësim interaktiv. Të mësuarit e tillë do ta mundësojë disponimi i njohurive paraprake që kanë nxënësit për problemet e përgjithshme shoqërore. Mësimdhënësi duhet t'i inkurajojë nxënësit për shprehje të lirë të mendimeve dhe të pikëpamjeve të tyre për problemet shoqërore.

Mësimdhënësi, së bashku me nxënësit, duhet të bëjë përpjekje për tejkalimin e mësimdhënies dhe të vlerësimit tradicional. Ndihmë për gjetje të metodave më të përshtatshme do të ishte bashkëpunimi mes arsimtarëve të sociologjisë dhe pjesëmarrja nëpër seminare të ndryshme me karakter didaktik.

Në mënyrë që arsimtari të ketë mësimdhënie cilësore dhe sukses sa më të lartë të nxënësit, mund të përdorë disa metoda dhe teknika, siç janë:

- Shpjegimi
- Puna në grupe
- Ndarja e klasës në dy grupe
- Diskutime të frytshme në zgjidhjen e problemit (debat)
- Furi (stuhi) mendimesh (brainstormingu)
- Vetëhulumtimi (kërkimi)
- Të shprehurit me gojë etj.

Gjatë procesit mësimor organizimi i nxënësve mund të jetë:

- Puna me grupe
- Puna me tërë klasën
- Puna në çifte dhe
- Puna individuale

**Puna në grupe dhe në çifte** parapëlqehet, me qëllim që nxënësit të lirohen nga emocionet e pakëndshme (frika) dhe së bashku të diskutojnë në grup, në mënyrë që të nxjerrin përfundime të sakta dhe me vlerë. Grupi mund të përbëhet nga 4-6 veta. Për temat që nxënësit kanë njohuri

paraprake, me sukses mund të zbatohet ligjërata interaktive e kombinuar me praktikën shoqërore.

**Metoda - diskutim** që zgjidh problemin ka për qëllim t'i theksojë se për probleme të ndryshme nuk ka vetëm një zgjedhje. Atëherë u mundësohet nxënësve të japin sa më shumë zgjidhje alternative dhe në fund të vlerësohet zgjidhja më e mirë.

**Metoda - furi mendimesh (brainstorming)** ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit të japin ide, zgjidhje dhe komente të shpejta për problemin e dhënë.

Arsimtari i përgatitur gjithnjë në qendër të vëmendjes e ka nxënësin dhe përdor strategji të ndryshme, që tek ai të zhvillohet të menduarit dhe vlerësimi kritik. Gjithmonë nga arsimtari kërkohet që mësimin ta bëjë sa më interesant dhe të mos krijojë monotoni. Arsimtari duhet t'i respektojë parimet didaktike, që edhe te nxënësit të krijojë shprehi të tillë që duke u nisur: prej të njohurës kah e panjohura, prej të thjeshtës nga e ndërlikuara, prej konkretes nga abstraktja dhe prej të veçantës nga e përgjithshmja, madje edhe t'i argumentojë mendimet e veta.

## VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve është pjesë e procesit mësimor. Përmes vlerësimit kuptojmë se sa nxënësit i kanë përfituar njohuritë që dalin nga objektivat e vetë planit dhe të programit. Vlerësimi, jo vetëm që është gjykim meritor për matjen cilësore dhe sasiore të njohurive, por shërben edhe nxitje për punë të mëvonshme. Vlerësimi mund të bëhet:

- Me kontroll të pandërprerë të veprimtarive në orë
- Me shkrim përmes testeve të llojeve të ndryshme (testet me përgjigje të shkurtra, me teste alternative, teste me kombinime, teste me përgjigje të shumta etj.), eseve etj.
- Gojarisht (mund të përdoret pjesërisht)
- Detyrat e shtëpisë
- Punë praktike

Vlerësimi duhet të bëhet në mënyrë sistematike (për çdo njësi mësimore), periodike dhe semestrale apo vjetore. Vlerësimi duhet t'i përmbajë këto veçori: **të jetë sistematik, objektiv, i vlefshëm, i besueshëm**

**shëm, i barabartë, i përshtatshëm, formues dhe duhet të bëhet në kohë të duhur.**

- **sistematik** – duhet të vlerësohet pas çdo njësie mësimore apo të një periudhe të caktuar kohore,
- **objektiv** - duhet që vlerësimi të bëhet në mënyrë të paanshme, pa marrë parasysh gjininë, prejardhjen etnike apo të farefisnisë,
- **i vlefshëm** – të vlerësohet realisht njohuria në bazë të kriterëve përkatëse.
- **i besueshëm** – vlerësimi të bëhet me të njëjtat standarde që te nxënësi të mos krijohen dilema,
- **i barabartë** – që nxënësve t'u jepen mundësi të barabarta edhe atëherë kur ndoshta përvojat e tyre nuk janë të njëjta,
- **i përshtatshëm** – duhet të vlerësohen në mënyrën që t'u përshtaten më së miri personalitetit të tyre për t'iu shmangur emocioneve të pakëndshme të nxënësve.
- **Vlerësimi në kohë të duhur** – vlerësimi duhet të bëhet gjatë vitit e jo krejt në fund të semestrit apo vitit, sepse nxënësi nuk ka kohë të përmirësohet.

### **Tipat e vlerësimit**

Detyrë me përgjegjësi e mësimit është planifikimi i vlerësimit dhe i kontrollimit të njohurive dhe të vështirësive të nxënësve, që të arrihet një sukses më i madh, ekzistojnë disa tipa të vlerësimit:

**Vlerësimi i bazuar në kriter:** ka për qëllim të kontrollojë njohuritë e nxënësve në bazë të kriterëve standarde. Përgjigjet e testit duhet të përcaktohen me pikë. Varësisht nga përqindja e pikëve të fituara, bëhet edhe vlerësimi. Caktimi i pikëve të përgjigjeve mbetet në përgjegjësinë e mësimit.

**Vlerësimi formues:** ka për qëllim që mësimit të planifikojnë punën e tyre në të ardhmen. Ky vlerësim bëhet në fillim ose gjatë vitit mësimor dhe jo me nota.

**Vlerësimi diagnostifikues:** ka për qëllim t'i zbulojë vështirësitë dhe dobësitë që hasin nxënësit. Paratestet nuk vlerësohen me nota, por shërbejnë vetëm si informacion për vështirësitë dhe dobësitë në të mësuar.

**Vlerësimi përmbledhës (kontrollues):** ky lloj testimi bëhet zakonisht në fund të gjysmëvjetorit të parë dhe në përfundim të mësimit. Ka për qëllim ta vlerësojë dhe të kontrollojë nivelin e njohurive të fituara gjatë një periudhe të caktuar.

## **LITERATURA**

1. Anthony Giddens, "Sociologjia", Shtëpia Botuese: Çabej, Tiranë 2002.
2. Dr. Ante Fiamengo, "Bazat e sociologjisë së përgjithshme", Rilindja, Prishtinë, 1984.
3. Brdhyl Musai, "Metodologjia e mësimit", Tiranë, 2003.
4. Zyvdi Dërvishi: "Sociologji kulture", Tiranë, 2001.
5. Sociologjia XI (për gjimnaze). LSH, Prishtinë, 2004.
6. Max Weber: "Studime sociologjike", Plejada, Tiranë, 2004.
7. Rothschild Joseph : "Kthimi në diversitet", Onufri, Tiranë.
8. Astrid Zipfel: "Hyrtje në shkencën e komunikimit dhe të publicistikës", Tiranë, 1998.
9. Koe Bailey: "Social Europe", London, 1992.